

DEMOKRATËT



E SË ARDHMES


FËMIJËT DHE DEMOKRACIA

ERA (8), DIJAR (9), BLIN (9), HERA (9), EDA (9), ERIS (9), SHEND (9), HANA (9)



Ne jemi të lumtur që jetojmë në një shtet demokratik dhe të pavarur

Demokracia filloi para 2500 viteve, më saktësisht në vitin 507 para erës sonë. Demokracia atëbotë ishte shumë e varfër, sepse femrat dhe të varfërit nuk i lejonin të merrnin pjesë në vendimet shtetërore. Në kohën tonë demokracia ka ndryshuar, tani ne kemi rregulla dhe kemi barazi gjinore. Sot, çdokush mund të



uar, e drejta për tu ushqyer, e drejta për tu shkolluar, e drejta për të luajtur, e drejta për tu strehuar, e drejta për të punuar, e drejta për tu mjekuar, e drejta për të ngrënë, etj.

Kosova është shtet i pavarur që 8 vite dhe ka demokraci. Si shtet jemi të pranuar në Lojëra Olimpikë dhe në lojëra të ndryshme sportive. Pavarësinë e Republikës së Kosovës e kanë pranuar shumë shtete.

jetë pjesë e demokracisë. Në demokraci ka rregulla dhe para ligjit të gjithë jemi të barabartë. Ne jemi të lirë të bëjmë zgjedhjen tonë dhe kemi zgjedhur të jemi qytetarë të mirë. Policia jep dënime për qytetarët që nuk i respektojnë rregullat.

Disa nga elementet kryesore të demokracisë janë liria e shprehjes, garantimi i të drejtave themelore të njeriut, respekti ndaj njëri-tjetrit, etj.

Të drejtat themelore të njeriut janë: e drejta për të jet-



Gazetarët e rinjë

PUSHTETI DHE DEMOKRACIA

ENSAR (9), FISNIK (9), LEKA (9), DEA (9), BLEDINA (9), STINA (9), DINA (9), GRETA (9)


Ne sot kemi mësuar për Kuvendin, Qeverinë, gjykatën, ligjet dhe demokracinë

Demokracia është qeverisja e popullit. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët „demos“ dhe „kratia“. „Demos“ në shqip është popull, ndërsa fjala „kratia“ në shqip është qeverisje. Ligjet janë rregullat që duhet zbatuar e gjithë Kosovës. Ne kemi rregulla edhe në shtëpi si për shembull: të ndihmojmë prindërit, të lajmë dhembët dy herë në ditë, të rregullojmë dhomën sa herë që shohim se nuk është në rregull, etj.


Qytetarët në shtetet demokratike i votojnë përfaqësuesit e tyre, e ata quhen deputetë. Deputetët punojnë në Kuvend. Kuvendi ushtron Pushtetin Legjislativ, Qeveria ushtron Pushtetin Ekzekutiv, kurse gjykata ushtron Pushtetin e Gjyqësorit. Këto institucione i trajtojnë të gjithë të barabartë.




Punëtorët



Pema e tri pushteteve



Punimet e fëmijëve




Roli i gjykatës



Gazetarët e famshëm

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

ERIS (9), FISNIK (9), DIELL (9), ELGJIN (9), ADEA (9), RINA (9), MELIKA (9)



Funksionet e Kuvendit të Kosovës

Pse Kuvendi është Pushteti Legjislativ? Kuvendi është Pushteti Legjislativ, sepse nxjerr dhe miraton ligje të ndryshme për të mirën tonë. Funksionet kryesore të Kuvendit janë: përfaqëson popullin përmes deputetëve, mbikëqyr Qeverinë dhe miraton ligje. Kuvendi përbëhet nga deputetët dhe Kryetari i Kuvendit. Roli i Kryetarit të Kuvendit është të bëjë planprogramin ditor së bashku me kryesinë e Kuvendit. Ky planprogram ka të bëjë me diskutimet që do të zhvillohen gjatë ditës. Në Kuvend propozohen projektligje të ndryshme. Të drejtën për të paraqitur projektligje kanë deputetët, Qeveria, Presidenti dhe populli. Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë. 20 prej tyre janë nga komunitetet jo shumicë. Deputet mund të jetë çdo person mbi moshën 18 vjeçare. Kandidatët për deputetë duhet t'i paraqesin planprogramet e tyre. Aty shkruhen planet se çka de-

putetët do të paraqesin para popullit.

Në Kuvend mbahen seanca të ndryshme, ku diskutohen tema të ndryshme për të mirën e popullit. Kuvendi i trajton të gjithë të barabartë pa dallim moshe, gjinie, race, ngjyre dhe feje. Sipas nesh për të qenë deputet duhet të jesh i sinqertë, të vepros sipas ligjeve të caktuara, të dëgjosh dhe të respektosh fjalën e popullit.

Kuvendi merr vendime të rëndësishme për të gjithë vendin, sidomos për ne nxënësit e shkollave. Vendimet më të rëndësishme për ne janë vendimet që merren për shëndetësi dhe arsim. Prandaj, ne duhet të zgjedhim deputetët që do të bëjnë më të mirën për Republikën e Kosovës. Ne, sot kemi mësuar për Shtëpinë e Popullit, e cila është Kuvendi. Ne nxënësit jemi shumë të gëzuar që kemi mësuar për elementet e demokracisë dhe kjo ishte një ditë shumë e mirë për ne.



QYTETARIA AKTIVE

ENSARA (9), BRILANTINA (9), MJELLMA (9), PËRPARIM (9), NIL (9), ORIK (9), SIMON (9)



Të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve

Secili qytetar ka të drejtat dhe përgjegjësitë e tij/saj. Edhe ne si qytetarë, kemi të drejta dhe përgjegjësi. Qytetaria e një shteti është shumë e rëndësishme, për shkak se qytetaria e përbën shtetin.

Një nga përgjegjësitë tona të shumta si qytetarë është të kujdesemi për ambientin tonë, të respektojmë ligjin, të mësojmë në shkollë, etj. Kosova është vend demokratik, prandaj të gjithë duhet të kemi të drejta të barabarta. Ne si qytetarë kemi të drejtën e shkollimit, lojës, zgjedhjes, votës, veshmbathjes, etj. E tërë kjo sigurohet në demokraci.



Autorët e artikullit



Ne jemi qytetarë aktivë



Ne si qytetarë jemi të barabartë



IMPRESUM

demos ti

Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga

TOKA

Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Faik Konica“
Klasa: IV-1
Vendi: Prishtinë